



**South Essex
Rape & Incest
Crisis Centre**

A keni nevojë të flisni
me dikë
në lidhje me ndonjë

**përdhunim ose
abuzim
seksual?**

Drejtohet nga femrat, për femrat

SERICC është hapur në vitin 1984 dhe mbulon zonat Thurrock, Basildon dhe Brentwood. Si organizatë vullnetare dhe bamirësie e regjistruar, organizata jonë është një organizatë në mirëbesim dhe e pavarur nga shërbimet sociale, policia dhe agjenci të tjera zyrtare.

SERICC i siguron një shërbim femrave dhe vajzave mbi moshën 13 vjeç, të cilat janë përdhunuar, dhunuar nga ana seksuale, të cilat kanë përjetuar abuzim seksual në fëmijëri, ngacmim seksual, ose të cilat kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës seksuale, ose tentativa për dhunë seksuale gjatë ndonjë kohe në jetën e tyre.

Mund të telefononi SERICC, nëse diçka po ndodh tani në jetën tuaj, apo nëse keni vështirësi për diçka që ka ndodhur në të kaluarën. Mund të telefononi gjithashtu, nëse jeni e shqetësuar për fëmijën tuaj, për dikë tjetër në familjen tuaj, apo për dikë që njihni.

Nëse na telefononi, ne mund t'ju ofrojmë këshillim me telefon dhe këshillim 'një me një', mbështetje emocionale dhe informata praktike. Ne nuk do t'ju tregojmë se çfarë duhet të bëni dhe nuk do të gjykojmë veprimet tuaja.

SERICC kërkon që të punojë duke u mbështetur në mënyra që shfaqin barazi, respekt dhe kujdes, dhe qëllimi ynë është që të jemi një organizatë e cila e pranon ndryshimin (në moshë, paaftësi, racë, besim, seksualitet dhe klasë) dhe të mos gjykojmë. Ne punojmë që të japim informata dhe burime që të mund të përdoren nga të gjitha femrat që ato të ndihmojnë vetveten.

Çfarë është këshillimi?

Këshillimi ju jep një hapësirë që ju ndihmon të kuptoni qartë veten dhe situatën tuaj. Këshillimi mund t'ju ndihmojë të gjeni përgjigjet tuaja për problemet që mund të jeni duke përjetuar, si rezultat i dhunës seksuale.

Këshilltaret e SERICC-ut nuk do t'ju detyrojnë asnjëherë të bisedoni për diçka që nuk jeni gati. Në takimet tuaja, këshilltarja mund t'i përgjigjet pyetjeve që keni për këshillimin apo për nevoja të tjera të përkrahjes. Ju dhe këshilltarja juaj do të shikoni nëse këshillimi i përmbush rregullisht nevojat tuaja.

Si të lini një takim/referim

Agjencitë e referimit duhet të jenë në dijeni që disa gra dhe vajza mund të kenë nevojë për mbështetje për të kontaktuar me SERICC dhe mund të mos kenë besim tek vetja e tyre për të kontaktuar të parat, ose ndoshta nuk e dinë se çfarë të presin.

Agjencitë e referimit duhet të plotësojnë një formular referimi që mund të shkarkohet nga faqja jonë e internetit www.sericc.org.uk; ose mund të kërkonte që formulari t'u dërgohet me faks ose me postë elektronike (e-mail).

Formulari duhet t'i dërgohet SERICC-ut para se të pranohet referimi – kjo do t'i japë mundësi SERICC-ut të kontaktojë sa më shpejt të jetë e mundur.

SERICC mund të pranojë gjithashtu vetë-referime, që do të thotë që ju mund të na kontaktoni drejtpërdrejt për të lënë një takim.

Shërbimet

Ne ofrojmë:

- Këshilltare me përvojë në çështjet e dhunës seksuale, të cilat janë të gjitha femra;
- Sesione këshillimi në një mjedis të rehatshëm;
- Këshillime falas në rast krizash, afatshkurtra ose afatgjata, 'një me një' dhe këshillime me anë të telefonit;
- Përkrahje emocionale dhe mbështetje;
- Takime me të njëjtën këshilltare.

Linja telefonike në rast ndihme:

Për disa gra dhe vajza, përdorimi i linjës telefonike në rast ndihme është hapi i parë për të biseduar se çfarë ka ndodhur në jetën e tyre. Ne do të ofrojmë informata dhe mbështetje për telefonuesit që janë duke përkrahur një partnere, një shoqe, një pjesëtare familjeje ose një kolege pune që ka përjetuar dhunë seksuale. Ne gjithashtu do t'i drejtojmë individët tek agjencitë përkatëse të mbështetjes, nëse ata/ju nuk jetoni në zonën tonë, ose jeni viktimë meshkuj si rezultat i dhunës seksuale.

Linja e këshillimit me telefon është e hapur për 9 orë në javë, kështu që mund të jetë e zënë. Nëse keni vështirësi që të lidheni, ju lutemi të provoni përsëri ose të lini një mesazh në sekretarinë telefonike dhe një këshilltare do t'ju telefonojë mbrapsht.

Këshillimi 'një me një':

Shërbimi ynë është për femrat që jetojnë ose punojnë në zonat e Thurrock, Basildon, Billerocay, Wickford dhe Brentwood. Sesionet e këshillimit mund të organizohen duke telefonuar numrin e linjës në rast ndihme **01375 380609**. Këshillimi pranë SERICC-ut mund të jetë afatshkurtër ose afatgjatë, në bazë të kërkesës, nga e hëna deri të shtunën dhe bëhet vetëm duke lënë takim (mund të sigurohet kujdestari për fëmijët, sipas kërkesës, për sesionet e këshillimit 'një me një').

SERICC është me qendër në Grays, Thurrock dhe ngandonjëherë mund të përdoren ndërtesa të tjera në Basildon dhe Brentwood, nëse është vështirë që të udhëtoni për tek SERICC. SERICC ndodhet në katin e parë dhe si e tillë nuk është plotësisht e lehtë për t'u përdorur; sidoqoftë ne mund të organizojmë takime këshillimi në një ndërtesë që është e lehtë për t'u përdorur në Grays, nëse është e nevojshme.

Mbështetje dhe përkrahje

SERICC mund të ndihmojë gjithashtu femrat të përdorin shërbimet e mëtejshme të përkrahjes dhe të marrin informata; për shembull policinë, profesionalët mjekësorë, procedurat gjyqësore, shërbimet sociale, ose strehim etj.

Përkrahja jonë përfshin gjithashtu:

- Përkrahje për ato nëna, fëmijët e të cilave kanë përjetuar abuzim seksual.
- Informata të shëndetit seksual, p.sh., infeksionet e ngjitura me rrugë seksuale, aborti, shtatzania, virusi i pamjaftueshmërisë së imunitetit njerëzor (HIV)/SIDA.
- Përkrahje kur merrni pjesë në takime për kontrolle të shëndetit seksual.
- Përkrahje për ju dhe familjen tuaj gjatë një çështje gjyqësore.

Punë të tjera që kryen SERICC:

- I ofron përkrahje dhe informata pjesëtarëve të familjes, shokëve dhe kujdestarëve.
- I drejton meshkujt dhe djemtë tek shërbimet përkatëse për viktimat meshkuj si rezultat i një dhune seksuale;
- Është përfaqësuese e çështjeve të femrave në rregulloret kombëtare dhe lokale si dhe në komitetet qeveritare;
- Bën fushata dhe rrit vetëdijen e njerëzve për çështjet e dhunës seksuale ndaj femrave;
- Bën prezantime, shfaqje dhe pajis me informata gjatë ngjarjeve që zhvillohen në komunitet;
- Mban lidhje me agjenci që kanë qëllime të ngjashme në shkallë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- I siguron një shërbim konsultimi për dhunën agjencive lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Merr pjesë në mënyrë aktive në projekte përtëritëse që bëjnë fjalë për përdhunimin dhe dhunën seksuale, duke përshtirë këtu edukimin dhe rritjen e vetëdijes tek të rinjtë;

- Merret me krahasimin e informatave statistike të dhunës seksuale që të përdoren në shkallë lokale dhe kombëtare, për të bërë të ditur për zhvillimin dhe përmirësimin e sigurimit të shërbimit për gratë;
- Siguron trajnime për shumë agjenci;
- Siguron shërbimin e marrjes hua të librave – Një bibliotekë me libra dhe burime;
- Siguron një faqe interneti që përmban informata për shërbimin tonë dhe lidhje me informata dhe organizata të tjera www.sericc.org.uk

Shërbimi i SERICC-ut ka marrë një Rezultat Cilësor të pavarur që bën të njohur se SERICC plotëson një numër treguesish cilësorë dhe kompetencash.

Këto përfshijnë:

- Përdorim të telefonit me shërbim anonim dhe pyetësorë përgjigjesh 'një me një'.
- Linjë veprimi në mirëbesim.
- Procedurë ankesash.
- Linjë veprimi të ndryshimit dhe mundësive të barabarta.
- Mbikqyrje klinike të pavarur të këshillimit.
- Linjë veprimi të shëndetit dhe sigurisë.
- I përmbahet direktivave dhe është anëtare organizatore e Shoqatës Britanike për Këshillim dhe Psikoterapi (**BACP**).

Kualifikimet e personelit punonjës përfshijnë:

- Punonjës me përvojë, të kualifikuar;
- Trajnime organizatore të SERICC-ut;
- Diplomim në degën e Studimeve për Femrat, BA (Hons);
- Diplomim në degën Psikologji, BSc (Hons);
- Diploma në studime profesionale të Këshillimit;
- Diplomë për Aftësitë e Marrëdhënieve midis Njerëzve;
- Diplomë në Këshillimin individual dhe të marrëdhënieve;

- Çertifikata në studimet profesionale të Këshillimit;
- Çertifikatë në studimet e Këshillimit dhe ndërhyrjet terapeutike për femrat që mposhtin përvojat e dhunës;
- Çertifikatë në ndërmjetësimin e lehtësimit të personave mbijetues ndaj dhunës seksuale dhe familjare;
- Çmime pas-profesionale në Këshillim;
- Çertifikatë në Menaxhimin e Vijës së Frontit.

Këshillimi, përkrahja dhe mbështetja nga SERICC financohet me anë të kontributeve nga:

- Trusti i Kujdesit Parësor të South West Essex (South West Essex Primary Care Trust).
- Këshilli i Thurrock-ut (Drejtoria për Mirëqenie, Fëmijët, Edukimin & Familjen, Përkrahja për Njerëzit, Sure Start).
- Ministria e Brendshme (Home Office).
- Krizat e Përdhunimit në Angli & Uells (Rape Crisis England & Wales).
- Donacione individuale, fonde të ngritura dhe fonde nga projekte specifike.

LINJA TELEFONIKE E KËSHILLIMIT ËSHTË E HAPUR:

Të mërkurën 10 paradite – 12 të drekës

Të enjteve 12 të drekës – 4 pasdite

Të shtunave 10 paradite – 1 pasdite

Këshillimi 'një me një' bëhet vetëm me anë të takimit.

Tel: 01375 380609

Faks: 01375 387053

Numri i Regjistrimit si Organizatë Bamirësie 287762

**QENDRA E SOUTH ESSEX-IT NË RASTE KRIZAZH PËR ÇËSHTJE
PËRDHUNIMI & ABUZIM SEKSUAL NGA NJË PJESËTAR FAMILJEJE
(SOUTH ESSEX RACE & INCEST CRISIS CENTRE)**

www.sericc.org.uk